

NewsLetter 20 Years



THE OFFICIAL NEWSLETTER OF THE AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE IN ALBANIA

OPINION EKONOMIK

Ngjarjet pasuese

KLEDI KODRA,
Managing Partner, Grant Thornton

Në ndikimi i përhapur i COVID-19 filloi gjatë periudhës së raportimit të njësishë ekonomike, ndikimi do të pasqyrohet në pasqyrat e saj financiare për atë periudhë. Sidoqoftë, në rastin që ndikimi COVID-19 ndodhi gjatë "periudhës së ngjarjeve vijuese" të njësishë ekonomike (d.m.th. periudha midis fundit të periudhës së raportimit dhe datës kur pasqyrat financiare janë të gatshme për publikim), mendimi duhet të përcaktojë se si zhvillimet pas përfundimit të vitit duhet të pasqyrohen në pasqyrat financiare të njësishë ekonomike për periudhën nën rishikim.

Në përputhje me SNK 10 'Ngjarjet pas periudhës së raportimit', njësive ekonomike u kërkohet të bëjnë dallimin midis ngjarjeve të mëvonshme që kërkojnë rregullim (d.m.th. ato që ofrojnë dëshmi të mëtijshme të kushteve që ekzistojnë në datën e bilancit) dhe jo rregulluese (d.m.th. ato që janë tregues i kushteve që u krijuan pas datës së bilancit). Subjekteve u kërkohet të rregullojnë shumat e njohura në pasqyrat e tyre financiare për të pasqyruar çdo ngjarje rregulluese që ndodh gjatë periudhës së ngjarjeve vijuese.

A ËSHTË NDIKIMI I COVID-19 NJË NGJARJE RREGULLUESE PËR PERIUDHAT E RAPORTIMIT QË PËRFUNDOI MË 31 DHJETOR 2019 (OSE MË PARË)?

Në këndvështrimin tonë, ndikimi i COVID-19 është përgjithësisht një ngjarje pasuese jo rregulluese për periudhat e raportimit të përfunduara në ose para 31 Dhjetorit 2019. Si pasojë, nuk do të ketë ndikim në njohjen dhe matjen e aktiveve dhe detyrimeve në pasqyrat financiare të një njësie ekonomike. Edhe pse rastet e virusit në qytetin Wuhan Kinw, u raportuan në Organizatën Botërore të Shëndetit (OBSh) më 31 Dhjetor 2019, kishte pak prova të konfirmuara të transmetimit nga njeriu-tek njeriu në atë kohë dhe OBSh e deklaroi shpërthimin si një emergjencë të shëndetit publik ndërkombëtar pas 31 janar 2020. Si i tillë, supozohet se zhvillimi dhe përhapja e rëndësishme e COVID-19 nuk ndodhi deri në janar të vitit 2020. Pasqyrat financiare për një njësie ekonomike me një periudhë raportuese që përfundon në ose para 31 dhjetorit 2019 duhet të pasqyrojnë vetëm kushtet që ekzistuan në 31 Dhjetor 2019 dhe për këtë arsye duhet të përjashtojë efektet domethënëse të shpërthimit të COVID-19....

» Vijnë në faqen 3

PANDEMIA

GARANCIA SOVRANE,

ÇFARË I SHKUALIFIKON BIZNESET NGA KREDIA?

Në faqen 2



AKTE LIGJORE

SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIDHJE ME PROCEDURAT, DOKUMENTACIONIN DHE MASËN E PËRFITIMIT TË NDIHMËS FINANCIARE PËR TË PUNËSUARIT AKTUALË DHE PËR TË LARGUARIT NGA PUNA SI PASOJË E COVID-19

» Në faqen 2

OPINION EKONOMIK

PANDEMIA PREJ COVID-19 SI NGJARJE QË PËRBËN FORCË MADHORE

Kris Hasa
Associate Frost & Fire Consulting

» Në faqen 4

Lajme Anëtarësh

NJË FILLIMI I RI: AUSTRIAN AIRLINES DO TË RIFILLOJË OPERACIONET E FLUTURIMIT MË 15 QERSHOR

» Në faqen 5

Welcomes
New Members

VEGA do te thotë: Vullnet, Energji, Garanci dhe Arritje

» Në faqen 5

Welcomes
New Members

"Souvenir Albania" 13-vite sukses në tregun shqiptar

» Në faqen 5

GARANCIA SOVRANE

ÇFARË I SKUALIFIKON BIZNESET NGA KREDIA

Garancia sovraane 2 tashmë ka marrë vulën zyrtare dhe 15 000 000 000 (150 milion dollarë) i janë shpërndarë bankave tregtare në mbështetje të bizneseve për të siguruar fondet e nevojshme për kapital qarkullues dhe investime për të mbështetur rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar që është ndikuar nga situata e krijuar nga COVID-19. Në paketën e parë financiare, të prezantuar më 19 mars, u parashikua një garanci sovraane me vlerë 100 milionë dollarë për bizneset në vështirësi që të merrnin kredi në banka për të paguar pagat e punonjësve, ku qeveria merrte përsipër edhe shlyerjen e interesave.

Qëllimi i skemës së garancisë është që të stimulojë huadhënien nga bankat tregtare që operojnë në Republikën e Shqipërisë, për t'i mundësuar tregtarëve ose shoqërive tregtare financimin e nevojshëm për të rimëkëmbur aktivitetin e tyre tregtar, i cili është prekur direkt ose indirekt nga aktet ligjore dhe nënligjore të qeverisë në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19.

Megjithatë jo çdo biznes i goditur nga pandemia Covid-19 do të mund të përfitojë nga kjo kredi. Bankat kanë qënë të qarta që në fillim të kësaj marrëveshje me tyre dhe shtetit se nuk do të rrisojnë me biznese që kanë një të kaluar problematike në skedarët e tyre. Bankat kanë dy kritere për të dhënë huanë. E para biznesi nuk duhet të jetë në listën e kreditorëve të këqij dhe e dyta, të mos jetë debitor në zyrën e tatim taksave. Kushi mbetet fakti se kjo kredi mund të përdoret vetëm për pagat e punonjësve



ÇFARË OFRON KREDIA MBI GARANCINË SOVRANE

- » Qeveria garanton 60% të principalit të çdo huaje, që bankat do të lëvrojnë për biznesin, sipas eksperiencave më të mira ndërkombëtare.
- » Ofron mundësi financimi me një afat shlyerjeje deri 5 vjet
- » Ofron hapësirën për të mos paguar principalin për një periudhë jo më pak se 6 muaj

CILAT JANË KRITERET E PËRZGJEDHJES

- » Biznesi nuk duhet të jetë në listën e kreditorëve të këqij
- » Nuk duhet të jetë debitor në zyrën e tatim taksave.
- » Kjo kredi mund të përdoret vetëm për pagat e punonjësve

DISBURSIMI I KREDISE MES BANKAVE TREGTARE

- Raiffeisen Bank sh.a. Albania, deri në vlerën 2 600 000 000 lekë;
- Banka Tirana sh.a. deri në vlerën 850 000 000 lekë;
- Banka Union sh.a. deri në vlerën 800 000 000 lekë;
- Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a. deri në vlerën 1 200 000 000 lekë;
- Banka Kombëtare Tregtare sh.a. deri në vlerën 2 550 000 000 lekë;
- Banka OTP Albania sh.a. deri në vlerën 1 450 000 000 lekë;
- Banka Procredit sh.a. deri në vlerën 600 000 000 lekë;
- Banka Alpha Albania sh.a. deri në vlerën 950 000 000 lekë;
- Banka Amerikane e Investimeve sh.a. deri në vlerën 650 000 000 lekë;
- Banka Credins sh.a. deri në vlerën 2 800 000 000 lekë;
- Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a. deri në vlerën 150 000 000 lekë;
- Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a. deri në vlerën 400 000 000 lekë.

“Garancia Sovraane II, ofron mundësi financimi për të gjitha sipërmarrjet e ndikuara në aktivitetet nga situata e pandemisë dhe me një historik pozitiv të marrëdhënies kreditore” - u shpreh Ministria Denaj, duke rikonfirmuar vendimin e bankave për të mos akorduar kredinë tek bizneset me nivel të lartë rrisiku.

Edhe Guverneri i Bankës së Shqipërisë, në daljen e tij publike, ndau një qëndrim thuajse të njëjtë me kreun e shoqatës së bankave. Guverneri Gent Sejko ka sqaruar se dhënia e këtyre kredive kërkon një analizë të kujdesshme, duke theksuar se jo të gjithë klientët mund të përfitojnë 100 % nga kjo garanci.



AKTE LIGJORE

Shtesa dhe ndryshime në lidhje me procedurat, dokumentacionin dhe masën e përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe për të larguarit nga puna si pasojë e Covid-19

PERGATITUR NGA DELOITTE ALBANIA

Në Fletoren Zyrtare nr. 97 është publikuar Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 423, datë 28.05.2020 i cili sjell disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 305, datë 16.04.2020 “Përpërcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e Covid-19”. Ju lutem referojuni Njoftimit nr. 33 të publikuar më herët nga Deloitte Albania lidhur me VKM nr. 305, datë 16.04.2020.

VKM ndryshuese parashikon dhënien e ndihmës financiare në masën 40,000 lekë, ndër të tjera, edhe për ish të punësuarit në subjekte që janë lejuar të kryejnë aktivitetet ose janë mbyllur sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët janë larguar nga puna nga data 01.03.2020 deri në 17.05.2020 (më parë, afati për të larguarit nga puna ishte deri në datën 10.04.2020).

Në rastet kur subjektet nuk aplikojnë për përfitimin e ndihmës financiare për të punësuarit apo të ish-punësuarit e tyre, ndihma financiare do të jepet pas miratimit nga administrata tatimore bazuar në të dhënat që zotëron ajo dhe në të dhënat që të punësuarit apo të ish-punësuarit do të dorëzojnë pranë saj. Të dhënat e mëposhtme:

Të dhënat e subjektit tatimpagues;

Të dhënat identifikuese të përfituesit;

Banka dhe numri i llogarisë bankare të përfituesit,

duhet të dorëzohen deri më 05.06.2020.

Për të punësuarit apo të ish-punësuarit që përfitojnë ndihmën financiare në bazë të këtij vendimi, nuk lejohet përfitimi në të njëjtën kohë nga paketat e tjera të mbështetjes shtetërore të pagesës së ndihmës ekonomike apo të pagesës së të ardhurës nga papunësia.

Lista emërore e individëve përfitues të Paketës Financiare 2 dhe lista e NIPT-eve të subjekteve tatimpaguese përkatës janë publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Parashikimet e mësipërme ligjore hyjnë në fuqi në mënyrë të menjëhershme duke filluar nga data 29.05.2020.



Kledi Kodra,

MANAGING PARTNER,
GRANT THORNTON

» Vijn nga faqja 1

...Sidoqoftë, njësitë ekonomike do të duhet të përcaktojnë nëse duhet të japin shenime shpjeguese shtesë për të përshkruar ndikimet e shpërthimit në periudhën e ngjarjeve vijuese. Në përgjithësi, duhet të jepen shenime të atyre ngjarjeve gjatë periudhës së ngjarjeve vijuese që nuk kanë të bëjnë me kushtet që ekzistonin në datën e pasqyrave financiare, por që shkaktojnë ndryshime të rëndësishme në aktivet ose detyrimet në periudhën pasuese dhe ose mund të ketë një efekt domethënës në veprimtarinë e ardhshme të njësisë ekonomike. Për ngjarjet jo-rregulluese materiale, një njësi ekonomike duhet të shpalojë

(a) një përshkrim të natyrës së ngjarjes;

(b) një vlerësim të efektit financiar, ose një deklaratë që një vlerësim i tillë nuk mund të bëhet.

Për më tepër, njësia ekonomike duhet të marrë parasysh vlerësimin e tyre për parimin e vijimesise dhe të rregullojë pasqyrat financiare, siç është e përshtatshme.

SHEMBUJ TË NGJARJEVE JO RREGULLUESE QË ZAKONISHT ÇOJNË NË PASQYRIM PËRFSHIJNË:

- planet e menaxhmentit për perballjen me efektet e shpërthimit të COVID-19 dhe nëse ka paqartësi materiale mbi aftësinë e njësisë ekonomike për të vazhduar në vijimesi

- shkelje të kontratave, heqje dorë ose ndryshime të kushteve kontraktuale në marrëveshjet e huazimit

- ndërprerjet e zinxhirit të furnizimit
- vlerësimi i marrëveshjeve të caktuara të blerjes ose shitjes si kontrata të mëdha

- shpalljen e një plani për të ndërprerë një operacion

- shpalljen, ose fillimin e zbatimit të një ristrukturimi ose reduktimi të rendesishëm aktivitetesh (përkohësisht ose përgjithmonë)

- rënie në vlerën e reale të investimeve të mbajtura pas periudhës raportuese (p.sh., investimet e planit të pensionit)

- Ndryshime anormale të mëdha në çmimet e asetëve ose në kursin e këmbimit, dhe

- hyrjen në angazhime ose kushte të rëndësishme, siç është lëshimi i garancive të rëndësishme për palët e lidhura.

CILI ËSHTË NDIKIMI I COVID-19 NË PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHAT RAPORTUESE QË PËRFUNDOJNË PAS 31 DHJETORIT 2019?

Që nga fundi i janarit të vitit 2020, numri i rasteve të COVID-19 dhe vendeve të prekura jashtë Kinës është rritur me shpejtësi, dhe më 11 mars 2020, OBSH deklaroi COVID-19 si një pandemi globale. Gjatë kësaj periudhe, qeveritë kombëtare dhe organizatat e ndryshme të sektorit privat kanë ndërmarrë masa të konsiderueshme për të frenuar virusin, përfshirë karantinat dhe mbylljen e shkollave, dyqaneve, kantierëve/uzinave dhe kufijve. Pasojat e shpërthimit kanë kontribuar gjithashtu në paqëndrueshmëri të konsiderueshme në bursat botërore të aksioneve që nga fundi i shkurtit 2020. Sipas mendimit tonë, për periudhat e raportimit pas 31 Dhjetorit 2019 (d.m.th. periudhat e raportimit që përfundojnë në vitin 2020), kishin më shumë informacion që përgatitësit dhe pjesëmarrësit e tregut do tju duhet të faktojnë në supozimet dhe vlerësimet e tyre. Prandaj, sa më vonë wshtw periudha e raportimit pas 31 dhjetorit 2019, aq më e

Ngjarjet pasuese



madhe është nevoja të merret parasysh nëse ndikimet e COVID-19 në periudhën e ngjarjeve vijuese duhet të konsiderohen si ngjarje që kërkojnë rregullim.

Për periudhat që përfundojnë pas 31 dhjetorit 2019, njësitë duhet të përdorin gjykimin e tyre për të përcaktuar ndikimin e COVID-19. Ata duhet të marrin në konsideratë me kujdes kushtet që ishin të pranishme në datën e raportimit. Kjo mund të mos rezultojë domosdoshmërisht në njësitë që arrijnë në të njëjtin përfundim për të njëjtën datë raportimi. Menaxhmenti duhet të marrë parasysh rrethanat specifike që lidhen me operimet e njësisë ekonomike dhe ngjarjet përkatëse që ekzistonin në juridiksionin e tyre në atë kohë. Për shembull, disa vende janë vënë në bllokim dhe u është thënë njerëzve që të mos largohen nga shtëpitë e tyre dhe disa vende jo. Nëse, për shembull, njësia ekonomike është në industrinë e mikpritjes, kjo mund të ketë një ndikim të madh. Kur ky gjykim ka një ndikim të konsiderueshëm në shumën e pasqyrat financiare, ai duhet të shpalojë në përfundim të SNK 1. Kur përcaktohet që COVID-19 ishte një ngjarje që ekzistonte dhe shkaktoi një ndikim në operacionet në ose para datës së raportimit, ngjarjet pas datës së raportimit duhet të llogariten si ngjarje rregulluese.

PARIMI I VIJIMESISE

Vlerësimi nase njw njësi ekonomike vazhdon punën ne baze te parimit te

vijimesise

SNK 1 përmban udhëzime në lidhje me supozimin e vijimesisedhe përshkruan kur pasqyrat financiare përgatiten mbi supozimin që njësia ekonomike do të vazhdojë në vijimesi për të ardhmen e parashikueshme. SNK 1 shpreh në mënyrë të qartë që në çdo datë raportimi, menaxhmenti kërkohet të vlerësojë aftësinë e njësisë ekonomike për të përmbushur parimin e vijimesise dhe të konsiderojë të gjithë informacionin në dispozicion i për të ardhmen, i cili është të paktën, por nuk është i kufizuar në, dymbëdhjetë muaj nga data e raportimit vjetor. Menaxhmenti duhet të marrë parasysh një gamë të gjerë faktorësh, siç janë: Pwrfitueshmeria e tashme dhe e pritur, afatet e ripagimit të borxhit dhe burimet e mundshme të financimit alternativ dhe aftësinë për të vazhduar ofrimin e shërbimeve. Nëse menaxhmenti arrin në përfundimin se njësia ekonomike mund të likuidohet (ose me zgjedhje ose sepse nuk ka alternativë tjetër realiste, përvece ta bëjë këtë), parimi i vijimesise nuk do të ishte i duhuri dhe pasqyrat financiare mund të duhet të përgatiten në një bazë tjetër, si p.sh. baza e likuidimit. Nëse ka paqartësi materiale në lidhje me aftësinë e njësisë ekonomike për të operuar në vijimesi, njësia ekonomike duhet të jape shenime shpjeguese rreth parimit të vijimesise në pasqyrat të saj financiare. Për shkak se vlerësimi në lidhje me aftësinë e një njësie ekonomike për të operuar në vijimesi përfshin periudhën jo më pak se dymbëdhjetë muaj nga data e raportimit vjetor, të gjitha ngjarjet që ndodhin gjatë periudhës së ngjarjeve pasuese të një njësie ekonomike duhet të merren parasysh kur vlerësojnë nëse ka dyshime të arsyeshme për aftësinë e njësisë ekonomike për të vazhduar në vijimesi. Me fjalë të tjera, edhe nëse ngjarjet gjatë periudhës së ngjarjeve vijuese nuk konsiderohen rregulluese, ato gjithsesi duhet të përfshihen në vlerësimin parimit të vijimesise. Për më tepër, ngjarjet ose kushtet që hedhin dyshime të mëdha në aftësinë e një njësie ekonomike për të operuar në vijimesi duhet të shpalojnë nëse janë paqartësi materiale ose nëse një sasi e konsiderueshme gjykimi është i përfshirë në arritjen e konkluzionit që parimi i vijimesise është i duhuri.

KONKLUZIONE

Është e rëndësishme të mbahet parasysh se kjo situatë vazhdimisht po lëviz. Vlerësimet duhet të mbahen të azhuruara, për shembull, ato të kryera dy javë para se të nënshkruhen pasqyrat financiare, me shumë mundësi do të jenë të vjetëruara dy javë më vonë. Pra, është thelbësore të sigurohemi që të gjitha gjykimet e bëra janë aktuale dhe të bazuara në informacionin e disponueshëm në datën më të fundit të mundshme (d.m.th. datën kur jepen autorizimet dhe miratimet e pasqyrave financiare).

Shpresojmë që t'i keni gjetur informacionet në këtë seri artikujsh të dobishëm. Tani më shumë se kurrë nevojë që klientët dhe auditori ose këshilltari i tyre të punojnë ngushtë janë thelbësore.



Kris Hasa

Associate Frost & Fire Consulting

Pandemia e shkaktuar nga Covid-19 i ka ndryshuar globalisht kushtet në të cilat operojnë bizneset, duke sjellë pasojat e gjithëditura, ndër të cilat kryesorja ka qenë pezullimi i aktiviteteve ekonomike. Në kushtet kur restorante, dyqane, fabrikat e shumë veprimtari të tjera u detyruan të mbyllen, vëmendja e të gjithë aktorëve u kthye te një dispozitë kontraktuale që deri tani konsiderohej rëndom si diçka rutinë që vetëm mbush faqet - klauzolat kontraktore për forcën madhore. Palët me detyrime të ndërsjella u vunë përballë anëve të ndryshme të llogores, secila duke u përpjekur të justifikojë mospërbushjen ose jo të detyrimeve në bazë të forcës madhore.

Por a përbën pandemia e Covid-19 një ngjarje të forcës madhore? Legjislacioni shqiptar, megjithëse e përmend forcën madhore disa herë, sidomos në Kodin Civil, nuk jep një përkufizim mbi të. Fatkeqësisht, edhe praktika gjyqësore në mungesë të ngjarjeve të tilla nuk ofron më tepër zgjidhje nga çfarë parashikon legjislacioni i shkruar. Përveç kësaj, Kodi Civil ka një pëstjellim të koncepteve të *forcës madhore* (pasojat e së cilës janë të pashmangshme dhe me kujdesin maksimal) dhe *rastit faktor* (i cili teorikisht është i shmangshëm me kujdes "mesatar"), që vështirëson dhe më tej klasifikimin e ngjarjeve që shkaktojnë pengesa në përbushjen e detyrimeve.

Nuk është vetëm legjislacioni shqiptar që dështon në dhënien e kuptimit të këtij koncepti, por edhe akte të së drejtës ndërkombëtare tregtare, konkretisht si Konventa për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave (CISG) që megjithëse rregullon situatën e pamundësisë së ekzekutimit të detyrimeve në Nenin 79 të saj, nuk përmend shprehimisht forcën madhore. Pavarësisht kësaj, është tashmë e gjithëpranuar që Neni 79 i CISG bën fjalë për këtë institut. Në këtë dispozitë paraqiten disa elemente kumulative për qenien në kushtet e

Pandemia prej Covid-19 si ngjarje që përbën forcë madhore



pamundësisë, që janë: ekzistenca e një pengese jashtë kontrollit të palës; që kjo pengesë të ketë qenë e paparashikueshme në kohën e lidhjes së kontratës dhe pengesa të jetë e pashmangshme. Nga sa më sipër kuptohet se baza e forcës madhore është prania e një pengese. Ngjarja e një pandemie si Covid-19 nuk mund të përbëjë automatikisht forcë madhore në çdo marrëdhënie civile apo tregtare. Për shembull, Amazon, kompania e tregtimit të mallrave online nuk mund të pretendojë Covid-19 si "forcë madhore" për të shmangur detyrime te saj ndërkohë që aktiviteti i saj tregtar është shtuar me më shumë se 30% për shkak të pandemisë. Duhet arsyetuar me kujdes se si pandemia ka ndikuar në marrëdhënien konkrete, nëse e ka vështirësuar apo nëse e ka bërë të pamundur ekzekutimin e detyrimeve. Nëse nuk ka patur një ndikim të tillë, pretendimi i forcës madhore do të ishte i pakuptimtë.

Nëse do të pranohej që ekziston

forca madhore në pengimin e përbushjes së detyrimeve të caktuara, çështja tjetër do të ishte identifikimi i pasojave që sjell ky fenomen në ato marrëdhënie. Efektet nuk mund të jenë të njëjta në të gjitha llojet e marrëdhënieve. P.sh. Kodi Civil ka parashikime të ndryshme nga Kodi i Punës. Sa më e veçantë të jetë një marrëdhënie e caktuar, aq më shumë duhen profilizuar dhe pasojat ligjore që vijnë nga forca madhore. Nga ana tjetër, nëse kontratat përmbajnë ndonjë klauzolë për forcën madhore, është i nevojshëm analizimi i tyre në raport me dispozitat ligjore, pasi jo çdo parashikim që palët mund të kenë bërë për ngjarjen e forcës madhore mund të jetë i vlefshëm apo i zbatueshëm në raste konkrete.

Gjithashtu, duhen vlerësuar posaçërisht dhe ato marrëdhënie ku detyrimet janë periodike në dallim me ato marrëdhënie ku detyrimet shlyhen menjëherë. Njëkohësisht duhet konstatuar nëse detyrimi bëhet i pa-

mundur për t'u shlyer vetëm përkohësisht, apo përgjithmonë. Ky relativitet ekziston për shkak se kryesisht dispozitat mbi pamundësinë e shlyerjes së detyrimeve ndodhen në pjesën e përgjithshme të detyrimeve në Kodin Civil, ndërsa pjesa e kontratave të veçanta jo gjithmonë rregullon situata të tilla shprehimisht. Kodi Civil më shumë se sa rregullon çështje specifike, vendos parime mbi këtë çështje, e për pasojë analiza duhet bërë rast pas rasti.

Kur në një kontratë me detyrime të dyanshme, ekzekutimi i detyrimit të një pale është bërë i pamundur pa fajin e asnjërës palë, secila prej tyre nuk ka të drejtë të kërkojë nga tjetra ekzekutimin e detyrimit ose shpërblimin e dëmit, përveç kur në ligj ose në kontratë është parashikuar ndryshe. Secila nga palët ka të drejtë të kërkojë nga pala tjetër që t'i kthejë atë që është dhënë për ekzekutimin e detyrimit (Neni 488 i Kodit Civil). Ky është rasti kur detyrimi është bërë tërësisht i pamundur, dhe qëllimi i kësaj dispozite të Kodit Civil, është t'i kthejë palët në gjendjen e mëparshme. Nga ana tjetër, neni 527 i Kodit Civil parashikon se kur pamundësia për ekzekutimin e detyrimit është e përkohshme, debitori nuk është përgjegjës për vonesën e ekzekutimit për kohën që ajo zgjat. Ky është një rast i ndryshëm nga ai i pari, ku ekzekutimi i detyrimeve nuk është bërë i pamundur përgjithmonë, por vetëm përkohësisht. Në këtë rast ligjvënësi nuk ka qëllim të zhbëjë marrëdhënien si në rastin e Nenit 488, por vetëm të përshtasë rrethanat që detyrimet të shlyhen sapo të jetë e mundur. Siç mund të kuptohet edhe nga sa u parashtrua më lart, standardi i legjislacionit shqiptar është pamundësia e ekzekutimit të detyrimit, dhe jo vështirësimi i tij. Pala nuk mund të çlirohet nga përgjegjësia kur përbushja e detyrimit është vështirësuar, për sa kohë është e mundur. Megjithatë, palët në kontratë mund të kenë vendosur ndryshe për këtë aspekt.

Si përfundim, çështja e pamundësisë së ekzekutimit të detyrimeve për shkak të një force madhore, është ende e debatueshme jo vetëm në Shqipëri, por kudo në botë, qoftë edhe në vendet më të arrira në fushën e legjislacionit. Duke qenë se çdo marrëdhënie është unike në një detaj apo në një tjetër, impakti që ka patur pandemia tek to, ka nevojë për një shqyrtim të kujdesshëm të fakteve dhe legjislacionit përkatës. Situata e krijuar nga Covid-19 duhet t'i shërbejë bizneseve në Shqipëri dhe jo vetëm, për të kuptuar rëndësinë e konsultimit me këshilltar juridik përpara se të gjenden para situatave të tilla, që të garantohen që kontrata të ndryshme që rregullojnë veprimtarinë e tyre tregtare i mbrojnë në mënyrë optimale interesat përkatëse.



Welcome



VEGA shpk u themelua më 19.08.1999 si një kompani me aktivitet në fushën e ndërtimit civile, për t'u zgjeruar më pas në të gjithë sektorin e ndërtimit. Sot VEGA Construction Group është një ndër kompanitë lider në menaxhimin e projekteve dhe në sektorin e shërbimeve të ndërtimit. Falë eksperiencës së përfutur në vite dhe investimeve të vazhdueshme në pajisje, makineri, fuqi punëtore etj. VEGA Construction Group ka zgjeruar aktivitetin e saj në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë ndërtime detare, infrastrukturorë, hidrocentrale, ndërtime civile, industriale, etj. Misioni i VEGA-s nuk ka ndryshuar që nga themelimi i saj. Për ne është i rëndësishëm

**VEGA DO,
TE THOTË:
VULLNET,
ENERGJI,
GARANCI
DHE
ARRITJE**

kombinimi i integritetit, i punës së pa-lodhur, profesionalizmit, me qëllim që të krijohet mundësia e një jete më cilësore, jo vetëm duke synuar tek konsumatorët por gjithashtu te punonjësit dhe partnerët. Këto nentem-bedhjetë vitet e eksperiencës kanë treguar se atë çfarë ne më parë e quanim ëndërr, sot janë projekte në ekzekutim. Misioni ynë ka qenë dhe akoma është investimi i vazhdueshëm në industrinë e ndërtimit dhe prodhimi i materialeve të ndërtimit në vend, gjithashtu investimi në ekipin dhe bashkëpunorët tonë. Ne duam të japim kontributin tonë modest për të rritur eksportet në Shqipëri dhe të krijojmë një nga kompanitë më të mëdha që operon në industrinë e ndërtimit, me qëllimin për të bërë të mirënjohur edhe në rajonin e Ballkanit. Qëllimi ynë është jo vetëm të rrisim financiarisht kompaninë, por ti investojmë më mirë të ardhurat në të mirë të imazhit të Shqipërisë. Pjesëmarrja në realizimin e investimeve publike të financuara nga organizatat ndërkombëtare dhe Qeveria Shqiptare na ka bërë në një pjesëmarrës aktiv në rindërtimin dhe modernizimin e infrastrukturës së Shqipërisë. Projektet dhe aktivitetet e Grupit VEGA mbështeten nga një staf shumë profesional dhe me eksperiencë. Një pjesë e stafit tonë e ka shoqëruar kompaninë që në fillimet e saj. Më vonë, me zgjerimin e aktivitetit, ne kemi shtuar grupin tonë me personel të kualifikuar. Ekzekutivët kanë qenë kohë mbas kohe dhe specialistë të huaj, të cilët kanë prezantuar te Grupi Vega metodologji të reja pune dhe njohuri të avancuara. Ne mund të ofrojmë mbështetje të plotë për çdo projekt, jo vetëm për projektet e Vega Grup por edhe për projektet e palëve të treta.



Welcome

SOUVENIR ALBANIA

Shkodra është një nga qytetet e Shqipërisë, ku vazhdon të përcillet tradita artizanale në punimet artistike. Pikërisht ky pasion për artizanatin ishte dhe një nga shkaqet kryesore që e nxiti Ardit Bilanin që në vitin 2007-të të themelonte në metropolin verior biznesin e tij "Souvenir Albania".

Një biznes me ndërthurje në mes traditës familjare dhe pasionit për artizanin bëri që të niste ëndrra e "Souvenir Albania" e cila kishte si qëllim kryesor rikthimin e vëmendjes tek sektori i artizanatit në një qytet me tradita si ai i Shkodrës.

Gjatë këtyre 13-viteve në tregun shqiptar "Souvenir Albania" është dalluar për korrektësi, shërbim profesional, cilësi dhe llojshmëri produktesh. Kjo ka bërë që interesi për këto produkte të jetë i konsiderueshëm duke ndikuar në shtrirjen e aktivitetit në të gjithë Shqipërinë.

Suksesi i "Souvenir Albania" është i prekshëm, ndërsa me prodhimet artizanale drejtuesi i këtij biznesi Ardit Bilani ka marrë pjesë në mbi 20 panairë kombëtare e ndërkombëtare përshi këtu Itali, Kanada, Mal të Zi etj, duke shkëmbyer eksperiencë me biznese të njohura në tregjet e huaja në fushën e souvenireve.

Vlen për tu theksuar gjithashtu pjesëmarrja në panairin ndërkombëtar të artizanatit, të organizuar në Fortezza da Basso në Firence, në vitin 2013, një nga panairët më të rëndësishëm për fushën e artizanatit për Shqipërinë në Itali, bashkë me atë të Milanos. Kjo pasi për herë të parë në këtë panair i'u dedikua një hapësirë edhe Shqipërisë, me përzgjedhje të Ministrisë së Turizmit, ku kishte mundësi të prezantohej me produkte artizanale si: souvenire, argjend, dru, tekstile dhe qëndisje, qeramikë dhe produkte të ndryshme. E natyrisht pjesë e tij ishte edhe Souvenir Albania. Ndërsa në Kanada, kompania Souvenir Albania ishte pjesë e panairit "Toronto Gift Fair", një panair i organizuar në 2018-tën.

Ndërkohë, është fakt se Souvenir Albania nuk i kanë munguar bashkëpunimet me institucione të ndryshme, qofshin ato në nivel lokal por edhe kombëtarë, pa harruar shoqatat apo subjekte të ndryshme private.

"Souvenir Albania" është një lider në tregun shqiptar dhe më gjërë. Kulmi i suksesit arrihet në sezonin e verës, ku ndaj produkteve vendore ka një interes të madh nga turistët e huaj por edhe ato vendas. Ndërkohë, në vitin 2013, Souvenir Albania nisi importin dhe eksportin e souvenireve me shumë vende të botës, duke bashkëpunuar me disa biznese prestigjioze në SH.B.A, Kanada, Turqi, Kinë. Bashkëpunimi i cili vijon edhe sot, duke pasur sukses nga të dyja palët.



LUFTHANSA GROUP

NJË FILLIMI I RI: AUSTRIAN AIRLINES DO TË RIFILLOJË OPERACIONET E FLUTURIMIT MË 15 QERSHOR

Kompania do të rifillojë fluturimin Tiranë - Vjenë me frekuencë 4 herë në javë në qershor dhe më shumë në korrik.



- Austrian Airlines do të rifillojë fluturimet e rregullta pas një ndërprerje prej afro 90 ditësh
- Rivendos fokusin në destinacionet evropiane dhe Tel Aviv
- Rregullim i vazhdueshëm i ofertës së fluturimit, rreth 40 destinacione të skeduluara deri në fund të qershorit
- Mbi 2,000 fluturime javore në lidhje me më shumë se 130 destinacione në të gjithë botën
- Lufthansa: 34 destinacione shtesë nga Mynihu, 20 më shumë nga Frankfurti në programin e fluturimit

Duke filluar nga 15 qershori, vetëm Lufthansa do të rifillojë rreth 20 destinacione gjermane dhe evropiane nga Frankfurti dhe rreth 34 nga Mynihu, duke plotësuar kështu orarin e fluturimit të kompanisë ajrore, e cila është rritur në mënyrë të vazhdueshme për disa javë.



FINANCAT KORREKTOJNË SHIFRAT E 4-MUJORE - TË ARDHURAT KAPITALE DHE SHPENZIMET RRIEN

Ministria e Financave ka korrigjuar shifrat e të ardhurave gjatë periudhës Janar-Prill 2020. Në publikimin e fundit të treguesve fiskalë, vihet re se të ardhurat totale janë raportuar me një rritje të lehtë prej 180 milionë lekësh, duke arritur shifrën e afro 133.2 miliardë lekësh. Ajo që duket se ka ndryshuar shifrat në buxhet, janë të ardhurat nga ndihmat, të cilat në treguesit e publikuar në muajin Maj rezultojnë në 4-mujor në 1.5 miliardë lekë, ndërsa tashmë regjistrohen në rreth 1.7 miliardë lekë.



309 BIZNESE KANË PËRFITUAR NGA GARANCIA SOVRANE, AHMETAJ: RAPORTI I BB, NË JEMI TË PËRGATITUR, SË SHPEJTI PO PARAQESIM PLANIN E RIMËKËMBJES EKONOMIKE

309 biznese kanë përfutur nga garancia sovranë me një vlerë gati 40 milionë dollarë nga

628 mijë aplikime nga instrumenti i parë, ndërkohë ka filluar aplikimi edhe për instrumentin e dytë. Ministri i Rindërtimit dhe kordinator për hartimin e Planit Kombëtar të Rimëkëmbjes Arben Ahmetaj në një dalje për mediat komentoi edhe vlerësimin e Bankës Botërore, duke deklaruar se qeveria është vigjilente dhe po përgatit një plan për rimëkëmbjen ekonomike.



SEJKO NË MBLEDHJEN E 43-TË TË KLUBIT TË GUBERNATORËVE: COVID-19, AKTIVITETI EKONOMIK PRITET TË BJERË, PRITET TË JETË I PËRKOHSHËM

Për shkak të përhapjes së pandemisë së Covid-19 gjatë vitit 2020, aktiviteti ekonomik pritet të shënojë rënie në Shqipëri, e cila parashikohet të jetë kalimtare dhe të rikuperohet më pas në vitet në vijim, deklaroi Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko në takimin e 43^{te} të Klubit të Guvernatorëve të vendeve të Azisë Qendrore, Rajonit të Detit të Zi dhe Ballkanit.

COVID-19

COVID -19 RREZIKON TË KTHEHET NË ARSIM NJË DEKADË MË VONË

Kriza e COVID ndër të tjera ka goditur rëndë edhe sektorin e arsimit. Mësimi në distancë në mënyrë masive rrezikon të përkeqësojë aftësitë e të rinjve dhe të çojë ato vite pas. Banka Botërore në një analizë të posaçme për ndikimin e arsimit nga kriza e Covid thotë se aftësitë e nxënësve shqiptarë rrezikojnë të kthehen në nivelet e vitit 2012.



AGJENTËT E BROKERIMIT NË LETRA ME VLERË, NDRYSHIMET E AMF NE LEGJISLACION, SI TË NEGOCIOSH MË KONTRATAT

Agjentët që operojnë për llogari të shoqërive të brokerimit do të njihen nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare si të tillë për aq kohë sa kanë një kontratë aktive. Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes miratoi pak kohë më parë disa ndryshime në rregulloren "Për veprimtarinë e agjentit të shoqërisë së brokeR-

imit në tituj" të cilat lidheshin specifcisht me nenin 18 të kësaj rregulloreje.

KRIZA FILLOI PARA COVID-19, MBYLLI 4,300 BIZNESE TË VOGLA NË 2019

Të dhënat e INSTAT bënë të ditur se në total, pa përfshirë bujqësinë, numri i subjekteve në vend ishte 116.6 mijë në vitin 2019. Në raport me një vit më parë janë mbyllur neto rreth 4 mijë biznese, me një rënie prej 2.5%. Të dhënat e detajuara të INSTAT bëjnë të ditur se kjo rënie ka ardhur tërësisht nga falimentimi i subjekteve të vogla më 1-4 punonjës.

E FUNDIT NË RAJON PËR SHPENZIMET SHËNDETËSORE - BB: QEVERIA SHQIPTARE DËRAGON VETËM 307 DOLLARË PËR FRYMË, 65% MË PAK SE PARAFUNDI

Shqipëria ka shpenzimet më të ulta publike për shëndetin për frymë në rajon, thotë Banka Botërore në serinë më të fundit të publikimeve për rajonin dhe ndikimin e covid-19. Në raportin dedikuar pikërisht sistemeve shëndetësore bie në sy fakti se, në Shqipëri shpenzimet publike për shëndetësinë fiksohen në vetëm 307 dollarë për frymë. Mesatarja e Bashkimit Europian është 10 herë më e lartë. Kjo shifër, prej 307 dollarësh për frymë është gjithashtu 65% më e ulët se ndjekësi më i afërt, që është Mali i Zi.